



FLETORJA ZYRTARE

E

REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

**Akte të papublikuara
të vitit 1996**

Ekstra 20

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Vendim i KM nr.340, datë 13.5.1996	Për disa shtesa në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.286, datë 30.5.1994 “Për administrimin e sendeve që kalojnë në dobi të shtetit nga kundërvajtjet administrative.....	5
Vendim i KM nr.343, datë 13.5.1996	Për fillimin e procedurave për rivlerësimin e pasurive të paluajtshme të bankave të nivelit të dytë me kapital tërësisht shtetëror.....	5
Vendim i KM nr.344, datë 13.5.1996	Për hapjen e aeroportit të Vlorës dhe të Beratit edhe për shërbime civile.....	6
Vendim i KM nr.351, datë 13.5.1996	Për kalimin në përdorim të Ministrisë së Drejtësisë të disa mjediseve të shtypshkronjës “Mihal Duri”.....	6
Vendim i KM nr.352, datë 13.5.1996	Për një ndryshim në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.351, datë 30.6.1993 “Për kualifikimin shkencor pasuniversitar dhe klasifikimin e punonjësve pedagogjikë e kërkimorë”.....	7
Vendim i KM nr.353, datë 13.5.1996	Për privatizimin e pjesshëm të shoqërisë tregtare “Albkrom”.....	7
Vendim i KM nr.355, datë 13.5.1996	Për kryerjen e regjistrimit të përgjithshëm të njësive ekonomike bujqësore.....	8

Vendim i KM nr.374, datë 20.5.1996	Për një shtesë në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.528, datë. 17.10.1994 “Për mënyrën e pagesës së banesave që financohen nga Enti Kombëtar i Banesave”.....	9
Vendim i KM nr.393, datë 27.5.1996	Për një shtesë në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.353, datë. 13.5.1996 “Për privatizimin e pjesshëm të shoqërisë tregtare “Albkrom””.....	9
Vendim i KM nr.397, datë 20.5.1996	Për mbrojtjen e veçantë të grave shtatzëna dhe të amësisë.....	10
Vendim i KM nr.398, datë 27.5.1996	Për denoncimin e marrëveshjes tregtare ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë dhe Qeverisë së Mbretërisë të Marokut.....	11
Vendim i KM nr.416, datë 10.6.1996	Për një shtesë në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.513, datë 26.10.1993 “Për organizimin dhe funksionimin e Komitetit të ish-të Përndjekurve Politikë”.....	11
Vendim i KM nr.428, datë 17.6.1996	Për perspektiven e zhvillimit të hekurudhave shqiptare.....	12
Vendim i KM nr.469, datë 1.7.1996	Për vjeljen e detyrimeve të subjekteve private në sistemin e shëndetësisë.....	14
Vendim i KM nr.494, datë 5.8.1996	Për Shkollën e Lartë të Infermierisë në Tiranë.....	15
Vendim i KM nr.510, datë 5.8.1996	Për ndalimin e riemërimit të nëpunësve publikë të larguar nga puna për korrupsion, mashtrim ose shkelje të tjera disiplinore, ndaj të cilave merret masa e largimit nga puna.....	15
Vendim i KM nr.550, datë 26.8.1996	Për mbylljen tërësore të disa minierave dhe sektorëve të ndërmarrjeve minerare të hekurnikelit, të qymyrgurit dhe të ndërmarrjes së ndërtim minierave metalore në Tiranë.....	16
Vendim i KM nr.552, datë 26.8.1996	Për miratimin e memorandumit të mirëkuptimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës ish-Jugosllave të Maqedonisë, në kuadrin e projektit të administrimit të liqenit të Ohrit.....	17
Vendim i KM nr.555, datë 26.8.1996	Për miratimin e marrëveshjes së grantit japonez ndërmjet Shqipërisë dhe Shoqatës Ndërkombëtare të Zhvillimit (IDA) si administratore e fondeve grant të dhëna nga Japonia për përgatitjen e projektit të dytë të transportit.....	17
Vendim i KM nr.556, datë 26.8.1996	Për miratimin në parim të projektit për administrimin e liqenit të Ohrit.....	18
Vendim i KM nr.587, datë 9.9.1996	Për disa ndryshime në ndarjen administrativo-tokësore të Republikës së Shqipërisë.....	19
Vendim i KM	Për zbatimin e “Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës të	19

nr.593, datë 9.9.1996	Shqipërisë dhe Qeverisë së SHBA-së për zgjidhjen e disa pretendimeve” ratifikuar me ligjin nr.7913, datë 6.4.1995.....	
Vendim i KM nr.594, datë 9.9.1996	Për miratimin në parim të marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë , Qeverisë së Republikës të Italisë dhe Institutit Mesdhetar të Agronomisë për zbatimin e projektit të mbrojtjes fitosanitare në Shqipëri.....	20
Vendim i KM nr.602, datë 9.9.1996	Për privatizimin e shoqërisë tregtare Miniera e Bitumit Selenicë.....	20
Vendim i KM nr.655, datë 23.9.1996	Për miratimin e strategjisë së privatizimit të bankave tregtare shtetërore.....	21
Vendim i KM nr.668, datë 7.10.1996	Për marrjen në dorëzim të arit shqiptar të grabitur nga gjermanët gjatë Luftës së Dytë Botërore.....	24
Vendim i KM nr.676, datë 14.10.1996	Për fillimin e punës së zyrës së regjistrimit të pasurisë së Paluajtshme në disa rrethe të vendit.....	24
Vendim i KM nr.677, datë 7.10.1996	Për miratimin në parim të marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë dhe Qeverisë së Republikës së Shqipërisë për bashkëpunimin financiar.....	25
Vendim i KM nr.693, datë 23.10.1996	Për miratimin në parim të akteve ”Mbi heqjen dorë nga të drejtat” dhe “Mbi marrjen në dorëzim” të arit shqiptar të grabitur nga gjermanët gjatë Luftës së Dytë Botërore.....	26
Vendim i KM nr.696, datë 14.10.1996	Për funksionimin e Komisionit të Letrave me Vlerë.....	26
Vendim i KM nr.762, datë 11.11.1996	Për pagimin e kuotës së statusit të vëzhguesit të Shqipërisë në Organizatën Botërore të Tregëtisë.....	27
Vendim i KM nr.765, datë 18.11.1996	Për ngritjen e Këshillit Drejtues të Entit Kombëtar të Zonave të Lira.....	27

Duke u abonuar për çdo vit pranë:

- çdo njësie postare të qyteteve;
- Qendrës së Publikimeve Zyrtare;

VENDIM
Nr. 340, datë 13.5.1996

PËR DISA SHITESA NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.286, DATË 30.5.1994 “PËR ADMINISTRIMIN E SENDEVE QË KALOJNË NË DOBI TË SHITETIT NGA KUNDËRVAJTJET ADMINISTRATIVE”

Me propozimin e Ministrisë së Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.286, datë 30.5.1994 në fund të pikës 1, shtohet:

“Të gjitha mallrat që sipas kriterëve të përcaktuara me ligj, kanë plotësuar kohën e qëndrimit në organet doganore dhe kalojnë në pronësi të shtetit, administrohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave të Shtetit.”.

Në fund të pikës 5 shtohet:

“Për mallrat, që në vazhdimësi do të kalojnë në pronësi të shtetit, organet administrative njoftojnë me shkrim Drejtorinë e Përgjithshme të Rezervave të Shtetit dhe degët e saj në rrethin ku vepron organi administrativ.

Këto mallra merren në administrim nga organet e rezervës shtetërore, brenda 20 ditëve nga çasti i njoftimit.”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi

VENDIM
Nr. 343, datë 13.5.1996

PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR VLERËSIMIN E PASURIVE TË PALUAJTSHME TË BANKAVE TË NIVELIT TË DYTË ME KAPITAL TËRËSISHT SHITETËROR

Në bazë të nenit 5 të ligjit nr.8083, datë 16.11.1995 “Për transformimin e bankave tregtare në shoqëri tregtare dhe lejin e privatizimit të tyre”, me propozimin e Ministrisë së Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Të gjitha bankat e nivelit të dytë me kapital tërësisht shtetëror, Banka Kombëtare Tregtare, Banka Tregtare Agrare dhe Banka e Kursimeve të fillojnë procedurat për rivlerësimin e pasurive të paluajtshme, në bazë të kriterëve të udhëzimit të Këshillit të Ministrave “Për rivlerësimin e kontabilizimit e pasurive të paluajtshme të bankave të nivelit të dytë me kapital tërësisht shtetëror”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi

VENDIM
Nr.344, datë 13.5.1996

PËR HAPJEN E AEROPORTIT TË VLORËS DHE TË BERATIT EDHE PËR SHËRBIME CIVILE

Me propozimin e Ministrisë së Ndërtimit dhe të Turizmit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Aeroportet e Vlorës dhe të Beratit të hapen edhe për shërbime civile.
 2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Industrisë, Transportit dhe Tregtisë dhe Ministria e Ndërtimit dhe e Turizmit.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi

VENDIM
Nr.351, datë 13.5.1996

PËR KALIMIN NË PËRDORIM TË MINISTRISË SË DREJTËSISË TË DISA MJEDISEVE TË SHTYPSHKRONJËS “MIHAL DURI”

Për funksionimin normal të zyrës së përmbartimit, të zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme, si dhe të shtypshkronjës për nevojat e sistemit të drejtësisë, me propozimin e Ministrisë së Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. T'i kalojnë në administrim Ministrisë së Drejtësisë:
 - a) Mjediset e punës për nëntëmbëdhjetë zyra, që sot janë në përdorim të shtypshkronjës “Mihal Duri”, të cilat gjenden në korridorin e katit të dytë, deri tek rruga e ambasadave me pamje nga hyrja kryesore, si dhe dy magazina në katin e parë të kësaj ndërmarrjeje që i përkasin repartit mekanik dhe repartit të ashpërsimit të lastrave, të ndodhura në pjesën veriperëndimore të godinës së shtypshkronjës “Mihal Duri” me dalje në rrugën e Kavajës.
 - b) Mjediset e punës, të përbëra nga punishtja e marangozit, punishtja e saldatorit me anekset dhe vendroja e karburantit që gjenden në territorin e shtypshkronjës “Mihal Duri”, prapa krahut në të majtë të godinës së drejtorisë dhe që kufizohen nga perëndimi rruga “Justin Godard”, nga veriu rruga “Halil Xhelo”, nga lindja e jugu oborri i mbapëm i godinës së drejtorisë me dalje në rrugën “Justin Godard”.
 2. Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Industrisë, Transportit dhe Tregtisë të marrin masa për lirim të këtyre ambienteve brenda datës 30 maj 1996.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi

VENDIM
Nr.352, datë 13.5.1996

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.351, DATË 30.6.1993 “PËR KUALIFIKIMIN SHKENCOR PASUNIVERSITAR DHE KLASIFIKIMIN E PUNONJËSVE PEDAGOGJIKË E KËRKIMORË”

Me propozimin e Komitetit të Shkencës dhe të Teknologjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.351, datë 30.6.1993 “Për kualifikimin shkencor pasuniversitar dhe klasifikimin e punonjësve pedagogjikë e kërkimorë” pika 2.4 ndryshohet si vijon:

“Në SHPU pranohen kandidatë shqiptarë e të huaj që kanë mbaruar shkollën e lartë brenda ose jashtë vendit me rezultate shumë të mira.”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi

**VENDIM
Nr.353, datë 13.5.1996**

PËR PRIVATIZIMIN E PJESSHËM TË SHOQËRISË TREGTARE “ALBKROM”

Në zbatim të ligjit nr.8026, datë 9.11.1995 “Për privatizimin e shoqërive tregtare që veprojnë në sektorin minerar”, me propozimin e Ministrisë së Burimeve Minerare dhe Energjetike, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Të privatizohet pjesa e Albkromit, e përbërë nga miniera e Bulqizës, miniera e Batrës, miniera e Tërnovës, impianti në Klos, uzina e ferrokromit në Burrel dhe një pjesë e impiantit të eksport-importit në Durrës.

2. Privatizimi i pjesës së Albkromit të bëhet me shitjen e 80 për qind të aksioneve shoqërisë gjermane Preussag Anlagenbau me çmim kuotues 3.5. milionë USD dhe pjesëmarrje me investime në infrastrukturë.

Investimet në infrastrukturë të jenë pjesë përbërëse e kontratës së shitjes dhe të shprehen në vlerë dhe afate për realizimin e tyre.

3. Hartimi i kontratës së shitjes të realizohet me asistencë të huaj.

4. Kontrata e shitjes miratohet nga Këshilli i Ministrave.

5. Pjesa tjetër e Albkromit, që nuk i nënshtrohet këtij vendimi, mbetet në juridiksionin e shoqërisë tregtare me të njëjtin emërtim.

6. Ngarkohet Ministria e Burimeve Minerare dhe Energjetike dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi

**VENDIM
Nr.355, datë 13.5.1996**

**PËR KRYERJEN E REGJISTRIMIT TË PËRGJITHSHËM TË NJËSIVE EKONOMIKE
BUJQËSORE**

Në mbështetje të nenit 9 të ligjit nr.7687, datë 16.3.1993 “Për statistikën”, me propozimin e Ministrisë së Bujqësisë e të Ushqimit dhe Institutit të Statistikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Regjistrimi i përgjithshëm i njësive ekonomike bujqësore shqiptare do të bëhet 1 herë në 10 vjet. Regjistrimi i parë do të fillojë në shtator të vitit 1996.
2. Ministria e Bujqësisë dhe e Ushqimit dhe Ministria e Financave, me propozimin e Institutit të Statistikës, miratojnë treguesit e nevojshëm.
3. Për organizimin dhe kryerjen e regjistrimit krijohet Komisioni Qendror i Regjistrimit. Ky komision cakton përbërjen e komisioneve lokale, si dhe të zyrave të regjistrimit në komuna e bashki. Përbërja e Komisionit Qendror të Regjistrimit është sipas listës që i bashkëngjitet këtij vendimi.
4. Për regjistrimin e përgjithshëm të njësive ekonomike bujqësore do të angazhohen Ministria e Bujqësisë dhe e Ushqimit, Instituti i Statistikës dhe Sekretariati i Shtetit për Pushtetin Lokal.
5. Instituti i Statistikës bën udhëheqjen metodologjike, përpunimin e të dhënave dhe botimin e rezultateve të regjistrimit.
6. Shpenzimet e nevojshme për mbulimin e kësaj veprimtarie të përballohen nga Instituti i Statistikës dhe nga ndihma e Qeverisë italiane.
7. Fusha e vrojtimit të regjistrimit të përgjithshëm të përfshijë të gjitha njësitë ekonomike bujqësore, blegtorale e pyjore (private ose shtetërore).
8. Subjektet private ose shtetërore, që janë objekt i regjistrimit të përgjithshëm të njësive ekonomike bujqësore, janë të detyruara të japin informacion korrekt e të vërtetë sipas pyetësorëve të hartuar nga Instituti i Statistikës.
9. Për kundërvajtësit zbatohen sanksione të parashikuara në ligjin nr.7687, datë 16.3.1993 “Për statistikën”.
10. Të dhënat e grumbulluara nga regjistrimi i përgjithshëm i njësive ekonomike bujqësore përbëjnë sekret statistikor. Shpërndarja dhe publikimi i tyre bëhet vetëm në formë të grupuar.
11. Ngarkohen Ministria e Bujqësisë dhe e Ushqimit dhe Instituti i Statistikës të nxjerrin udhëzimet përkatëse në zbatim të këtij vendimi.
12. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi

PËRBËRJA E KOMISIONIT QENDROR TË REGJISTRIMIT

1. Ministri i Bujqësisë dhe i Ushqimit	Kryetar
2. Drejtori i Përgjithshëm i INSTAT-it	Sekretar
3. Sekretari i Shtetit për Pushtetin Lokal	Anëtar
4. Kryeregjistratori i pasurive të paluajtshme	“
5. Drejtori i Drejtorisë së Kadastrës në Ministrinë e Bujqësisë dhe të Ushqimit	“
6. Drejtori i Drejtorisë së Bujqësisë në Ministrinë e Bujqësisë dhe të Ushqimit	“
7. Drejtori i Drejtorisë së Statistikave në Ministrinë e Bujqësisë dhe të Ushqimit	“
8. Shefi i Departamentit të Bujqësisë në INSTAT	“

VENDIM
Nr.374, datë 20.5.1996

**PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.528, DATË.
17.10.1994 “PËR MËNYRËN E PAGESËS SË BANESAVE QË FINANCOHEN NGA ENTI
KOMBËTAR I BANESAVE”**

Me propozimin e Ministrisë së Ndërtimit dhe të Turizmit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.528, datë 17.10.1994, në pikën 2 shtohet një paragraf me përmbajtje si vijon:

“Në raste të veçanta personat e pajisur me autorizime për strehim sipas listës nominale të miratuara nga Kryetari i Këshillit të Ministrave sipas pikës 6 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.530, datë 17.10.1994 “Për mënyrën e ndarjes së apartamenteve të ndërtuara nga Enti Kombëtar i Banesave”, mund të lidhin kontratë të përkohshme të shitjes së apartamentit me Entin Kombëtar të Banesave që nga momenti i shpalljes së prokurimit të banesës.

Në këtë rast këto persona janë të detyruar të parapaguajnë një kësht fillestar sa 20% të vlefës së apartamentit të përcaktuar nga Enti Kombëtar i Banesave sipas koston mesatare për atë vit”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi

**VENDIM
Nr.393, datë 27.5.1996**

**PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.353, DATË.
13.5.1996 “PËR PRIVATIZIMIN E PJESSHËM TË SHOQËRISË TREGTARE
“ALBKROM””**

Në zbatim të ligjit nr.8026, datë 9.11.1995 “Për privatizimin e shoqërive tregtare që veprojnë në sektorin minerar”, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.353, datë 13.5.1996, në paragrafin e parë të pikës 2 shtohet një fjali me këtë përmbajtje:

“20 për qind e aksioneve të privatizohet sipas programit të privatizimit masiv”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi

**VENDIM
Nr.397, datë 20.5.1996**

PËR MBROJTJEN E VEÇANTË TË GRAVE SHTATZËNA DHE TË AMËSISË

Në zbatim të ligjit nr.7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e Ministrisë së Punës, Emigracionit, Përkrahjes Sociale dhe ish-të Përndjekurve Politikë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Mbrojtja e aftësisë për të qenë nënë

1. Ndalohet zënia me punë e grave, kur janë ende të afta për të bërë fëmijë, në veprimtaritë që

parashikohen në një listë të përgatitur nga Këshilli i Ministrave.

Vlerësimi i rreziqeve

2. Për çdo veprimtari që paraqet rrezik ekspozimi ndaj agjentëve, proceseve ose kushteve të punës të përcaktuara nga Këshilli i Ministrave, natyra, shkalla dhe kohëzgjatja e ekspozimit ndaj tyre e grave shtatzëna, lehonave apo nënave me fëmijë në gji duhet të vlerësohen nga punëdhënësi, me qëllim që:

a) të merret parasysh çdo rrezik për sigurinë dhe shëndetin, si dhe çdo pasojë mbi shtatzëninë dhe të dhënit e gjirit të fëmijës;

b) të përcaktohen masat që duhen marrë.

Përshtatja e kushteve të punës

3. Nëse rezultatet e vlerësimit të parashikuar në pikën 2 nxjerrjen në pah qenien e një rreziku për shëndetin, sigurinë a një pasojë mbi shtatzëninë ose të dhënit e gjirit të fëmijës, punëdhënësi duhet të marrë të gjitha masat, në mënyrë që nëpërmjet përshtatjes së përkohshme të kushteve të punës apo të kohës së punës, ekspozimi i kësaj kategorie punonjësish të mënjanohet.

Nëse përshtatja e kushteve ose e kohës së punës nuk është teknikisht a objektivisht e mundur, ose nuk mund të kërkohet për arsye të justifikueshme, atëherë punëdhënësi duhet të marrë të gjitha masat e nevojshme për t'i siguruar punonjësës në fjalë një ndërrim vendi pune.

Nëse ndërrimi i vendit të punës nuk është teknikisht apo objektivisht i mundshëm ose nuk mund të kërkohet për arsye të justifikueshme, punonjësja në fjalë lirohet nga puna për një periudhë të nevojshme për mbrojtjen e sigurisë apo të shëndetit të saj.

Veprimtaritë e ndaluara

4. Gratë shtatzëna nuk mund në asnjë rast të detyrohen të kryejnë veprimtari që paraqesin një rrezik ndaj ekspozimit me agjentët ose kushtet e punës, të parashikuara në një listë të përgatitur nga Këshilli i Ministrave e që vënë në rrezik sigurinë a shëndetin e tyre.

Nënat me fëmijë në gji nuk mund në asnjë rast të detyrohen të kryejnë veprimtari që paraqesin një rrezik ndaj ekspozimit me agjentët ose kushtet e punës, të parashikuara në një listë të përgatitur nga Këshilli i Ministrave e që vënë në rrezik sigurinë a shëndetin e tyre.

Kohëzgjatja e punës për gratë shtatzëna dhe nënat me fëmijë në gji

5. Gratë shtatzëna dhe nënat me fëmijë në gji nuk mund të detyrohen të fillojnë punën e ditës para orës pesë në verë (apo gjashtë në dimër) dhe as të vazhdojnë atë pas orës 20.

Gratë shtatzëna dhe nënat me fëmijë në gji kanë të drejtë që të kërkojnë të marrin leje nga puna; punëdhënësi ka të drejtë të kërkojë paraqitjen e një raporti mjekësor.

Gratë shtatzëna dhe nënat me fëmijë në gji kanë të drejtë të bëjnë pushime herë pas here gjatë ditës, me kusht që këto pushime të justifikohen nga gjendja e tyre.

Kur gruaja s'mund të kryejë një punë për arsye të rrezikut që ajo paraqet, atëherë punëdhënësi duhet t'i caktojë një punë tjetër dhe në pamundësi t'i paguajë pagën.

Shqyrtimi i listave

6. Inspektorati Shtetëror i Punës kujdeset që listat e veprimtarive, agjentëve dhe kushteve të punës, të parashikuara në këtë vendim, të jetë gjithmonë në përputhje me zhvillimet e fundit.

Inspektorati shqyrton të paktën një herë në vit përmbajtjen e këtyre listave dhe i bën gjithë propozimet e duhura Ministrisë të Punës, për t'i paraqitur për miratim në Këshillin e Ministrave.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi

VENDIM
Nr.398, datë 27.5.1996

**PËR DENONCIMIN E MARRËVESHJES TREGTARE NDËRMJET KËSHILLIT TË
MINISTRAVE TË REPUBLIKËS POPULLORE SOCIALISTE TË SHQIPËRISË DHE
QEVERISË SË MBRETËRISË TË MAROKUT**

Me propozimin e Ministrisë së Industrisë, Transportit dhe Tregtisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Denoncimin e marrëveshjes tregtare ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës Socialiste të Shqipërisë dhe Qeverisë së Mbretërisë të Marokut, të nënshkruar më 30 tetor 1984 në Rabat të Mbretërisë të Marokut.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Ministria e Punëve të Jashtme.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi

VENDIM
Nr.416, datë 10.6.1996

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.513, DATË 26.10.1993 “PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E KOMITETIT TË ISH-TË PËRNDJEKURVE POLITIKË”

Me propozimin e Ministrisë së Punës, Emigracionit, Përkrahjes Sociale dhe ish-të Përndjekurve Politikë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.513, datë 26.10.1993 “Për organizimin dhe funksionimin e Komitetit të ish-të Përndjekurve Politikë”, pika 5 në shkronjën “c”, pas fjalëve “...Shoqatën Kombëtare të ish-të Përndjekurve Politikë” shtohen dhe fjalët “...Shoqatën Kombëtare të ish-të Përndjekurve Politikë e Ekonomikë (ish-kulakë)”.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi

VENDIM
Nr.428, datë 17.6.1996

PËR PERSPEKTIVËN E ZHVILLIMIT TË HEKURUDHAVE SHQIPTARE

Me propozimin e Ministrisë së Industrisë, Transportit dhe Tregtisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Të miratojë skenarin e zhvillimit të ardhshëm të hekurudhave shqiptare, të mbështetur nga rekomandimet e studimit të kryer nga Instituti Irlandez CIE-Consult, me fonde të projektit të parë të transportit të financiar nga Banka Botërore, si më poshtë:
 - a) Veprimtaria e transportit të mallrave të shtrihet në të gjithë rrjetin hekurudhor.
 - b) Veprimtaria e transportit të udhëtarëve të vazhdojë në të gjithë rrjetin, me përjashtim të rasteve kur studimet ekonomike e financiare rezultojnë me humbje më të madhe sesa ajo e parashikuar në programin ekonomik të vitit në fjalë për këtë veprimtari.
2. Treguesit ekonomikë, financiarë dhe investimet deri në vitin 2005, sipas studimit, janë parashikuar në tabelën bashkëngjitur këtij vendimi. Treguesit e çdo viti miratohen me një marrëveshje që lidhet për një periudhë jo më pak se dyvjeçare ndërmjet Këshillit të Ministrave ose organit të

autorizuar prej tij dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Hekurudhave.

3. Për zhvillimin perspektiv të hekurudhave të konsiderohet prioritare zgjerimi i rrjetit hekurudhor në korridorin perëndim-lindje sipas studimeve të kryera për këtë qëllim.

4. Ministria e Industrisë, Transportit dhe Tregtisë të studiojë dhe të përcaktojë mënyrën e formën e privatizimit në proceset e operimit nëpërmjet mbështetjes së konsulencës së huaj dhe të paraqesë projektligjin përkatës në Këshillin e Ministrave.

5. Në përputhje me studimin, Drejtoria e Përgjithshme e Hekurudhave të marrë masa për përmirësimin e sistemit të drejtimit dhe të organizimit, për ngritjen e zhvillimin e sektorëve të biznesit, për ndarjen e sektorit të infrastrukturës nga shfytëzimi i mjeteve të transportit, për hartimin e legjislacionit të ri për t'iu përshtatur kërkesave të ekonomisë së tregut dhe rekomandimeve e standardeve ndërkombëtare.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi

DISA NGA TREGUESIT ME Kryesore te zhvillimit te transportit Hekurudhor

PER PERIUDHEN 1996 - 2005

Emertimi	Njesia	1996	1997	1998	1999	2000	2001	2002	2003	2004	2005
Vellimet e punes											
Trans. i udhetareve	mln ukm	218.4	234.9	247.5	261.8	284.2	285.4	286.5	287.7	288.8	290
Trans. i mallrave	mln tkm	56.6	60.5	64.8	69.3	74.3	78	81.8	85.9	90.2	94.6
Fuqia punetore	punonjes	4800	3500	3000	2700	2500	2440	2380	2320	2260	2200
Te ardhurat	mil. leke	526.2	552.5	590.1	614.3	625.4	636.5	647.5	659.5	683	706.5
Shpenzimet	mil. leke	934.7	794.7	752.6	729.6	725.9	730.2	733.3	741	761.3	782
Raporti te ardh/shp	%	56.3	69.5	78.4	84.1	86.1	87.2	88.3	89	89.7	90.3
Subvencioni	mil. leke	408.5	242.2	162.5	115.3	100.5	93.7	85.8	81.5	78.3	75.5
Investimet	mil. leke	345	364	364	340	325	325	180	180	180	180
Subvenc+invest.	mil. leke	753.5	606.2	526.5	455.3	425.5	418.7	265.8	261.5	258.3	255.5

Shenim: Treguesit e mesiperme jane llogaritur duke u bazuar ne nivelin e tarifave dhe cmimeve te vitit 1995

VENDIM
Nr.469, datë 1.7.1996

PËR VJELJEN E DETYRIMEVE TË SUBJEKTEVE PRIVATE NË SISTEMIN E SHËNDETËSISË

Në zbatim të ligjit nr.7850, datë 29.7.1994, me propozimin e Ministrisë së Financave dhe të Ministrisë së Shëndetësisë e të Mbrojtjes së Mjedisit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Subjektet që kanë dalë në profesion privat në shërbimet shëndetësore të stomatologjisë dhe të rrjetit të hapur të farmacisë, deri në datën 31.7.1996, të shlyejnë, në favor të Buxhetit të Shtetit, detyrimet që kanë kundrejt shtetit për mjetet e punës që kanë privatizuar, qiratë e mjediseve që kanë marrë dhe kanë në posedim, si dhe për ilaçet që kanë marrë në ngarkim me rastin e privatizimit.

2. Degët e Agjencisë Kombëtare të Privatizimit në rrethe detyrohen të përfundojnë, brenda datës 31.7.1996, gjithë dokumentacionin e paraqitur pranë tyre prej drejtorive të shëndetit publik dhe ish-ndërfarmave, që lidhet me privatizimin e mjeteve të punës dhe dhënien me qira të objekteve që kanë në posedim subjektet, sipas pikës 1 të këtij vendimi.

3. Përcaktimi i detyrimeve të bëhet duke u bazuar në dokumentet e furnizimeve të bëra me subjektet specialistë që kanë marrë në dorëzim mjetet e punës dhe ilaçet, si dhe vlerësimeve të bëra për caktimin e qirave për objektet që kanë në posedim subjektet e përmendura në pikën 1 të këtij vendimi.

4. Kur individët debitorë kundrejt drejtorive të shëndetit publik dhe ish-ndërfarmave nuk shlyejnë detyrimet për të cilat kanë marrë njoftim, të merren masa detyruese deri në heqjen e licencës profesionale.

5. Në rastet kur subjektet e përcaktuara në pikën 1 të këtij vendimi nuk kanë likuiduar detyrimet për mjetet e punës që kanë marrë në posedim, qiratë e objekteve që kanë në posedim dhe ilaçet që kanë marrë prej ndërfarmave, degët e Agjencisë Kombëtare të Privatizimit në rrethe dhe drejtoritë e shëndetit publik të ngrenë padi në gjykatë për likuidimin e detyrimeve të papërmbyshura që rrjedhin nga marrja në dorëzim e mjeteve të punës, shitja e barnave që kanë marrë në dorëzim, si dhe nga kontrata e qirasë së mjediseve dhe, kur është rasti, të kërkohet edhe zgjidhja e kontratës dhe shpërblimi i dëmit të shkaktuar nga mospërmbyshja e detyrimeve.

Për mjediset e punës, për të cilat nuk është lidhur kontratë qiraje, të kërkohet pushimi i posedimit, dorëzimi i mjedisit dhe shpërblim për të gjithë kohën e përdorimit të tij.

6. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Ministria e Financave (policia tatimore) Ministria e Shëndetësisë dhe e Mbrojtjes së Mjedisit (drejtoritë e shëndetit publik në rrethe) dhe Agjencia Kombëtare e Privatizimit (degët në rrethe), të cilat të rakordojnë ndërmjet tyre punën edhe me organet kompetente ekzekutive të ngarkuara nga dispozitat ligjore në fuqi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi

VENDIM
Nr.494, datë 5.8.1996

PËR SHKOLLËN E LARTË TË INFERMERISË NË TIRANË

Në mbështetje në ligjit nr.7810, datë 6.4.1994 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe me propozimin e Ministrisë së Shëndetësisë dhe të Ambientit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kursi i personelit të mesëm mjekësor në Tiranë pranë Ministrisë së Shëndetësisë dhe të Ambientit emërtohet Shkolla e Lartë e Infermierisë në Tiranë, në vartësi të Ministrisë së Arsimit të Lartë dhe Kërkimeve Shkencore.

2. Profili i studimit në këto degë do të jetë:

- Infermier i përgjithshëm 3.5 vjet.

3. Ministria e Shëndetësisë vë në dispozicion të Ministrisë së Arsimit të Lartë dhe Kërkimeve Shkencore ndërtesën, pajisjet dhe personelin e këtij kursi.

4. Ministria e Financave, Ministria e Shëndetësisë dhe e Ambientit dhe Ministria e Arsimit të Lartë dhe Kërkimeve Shkencore sigurojnë kalimin e fondeve të nevojshme për funksionimin e Shkollës së Lartë të Infermierisë në Tiranë.

5. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe e Ambientit dhe Ministria e Arsimit të Lartë dhe Kërkimeve Shkencore.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE

Aleksandër Meksi

VENDIM

Nr.510, datë 5.8.1996

PËR NDALIMIN E RIEMËRIMIT TË NËPUNËSVE PUBLIKË TË LARGUAR NGA PUNA PËR KORRUPSION, MASHTRIM OSE SHKELJE TË TJERA DISIPLINORE, NDAJ TË CILËVE MERRET MASA E LARGIMIT NGA PUNA

Në zbatim të nenit 32 të ligjit nr.8095, datë 21.3.1996 “Për shërbimin civil në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Kryetarit të Këshillit të Ministrave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Çdo nëpunës, ndaj të cilit, sipas ligjeve e akteve nënligjore në fuqi, është marrë masa disiplinore e largimit nga puna për arsye korrupsioni, mashtrimi ose shkeljesh të tjera, për të cilat merret kjo masë, konsiderohet i papërshtatshëm për t’u mbajtur a emëruar në çfarëdoq postit të shërbimit publik.

2. Nëpunësit e larguar nga puna në ministrinë ose institucionet publike për arsyet e sipërpërmendura nuk duhet të pranohen në punë nga ministrinë dhe institucionet e tjera. Për këtë çdo ministri dhe institucion duhet të veprojnë në këtë mënyrë:

a) Të vënë në dijeni Departamentin e Administratës Publike për çdo largim nga puna për arsyet e sipërpërmendura, duke dhënë informacionin vijues:

- emrin, adresën dhe numrin e letërnjoftimit të nëpunësit të larguar, datën e emërimit e të largimit nga puna, si dhe arsyet e sakta të largimit nga puna.

b) Të vënë në dijeni Departamentin e Administratës Publike për emrin, adresën dhe numrin e letërnjoftimit të çdo kandidati për emërim. Personat do të emërohen në punë vetëm pasi Departamenti i Administratës Publike të ketë kontrolluar dhe të jetë siguruar që këto persona nuk kanë qenë të larguar nga puna në shërbimin publik për arsyet e lartpërmendura.

c) Të refuzojnë emërimin e kandidatit, nëse informohet nga Departamenti i Administratës Publike se ky kandidat është larguar nga puna për arsyet e lartpërmendura.

3. Ministria do të ketë liri veprimi për të emëruar ose jo, nëse largimi nga puna ka qenë për arsye të tjera të ndryshme nga ato të lartpërmendura.

4. Në rastin e marrjes së masës disiplinore të largimit nga puna, ky vendim zbatohet për atë kohë sa kjo masë disiplinore është në fuqi. Për largimin nga puna për korrupsion ose mashtrim, masat e dhëna nga ky vendim janë të përhershme.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi

VENDIM
Nr.550, datë 26.8.1996

**PËR MBYLLJEN TËRËSORE TË DISA MINIERAVE DHE SEKTORËVE TË
NDËRMARRJEVE MINERARE TË HEKURNIKELIT, TË QYMYRGURIT DHE TË
NDËRMARRJES SË NDËRTIM MINIERAVE METALORE NË TIRANË**

Me propozimin e Ministrisë së Burimeve Minerare dhe Energjetike, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Mbylljen tërësore të disa minierave dhe sektorëve të ndërmarrjeve minerare të hekurnikelit, qymyrgurit dhe të ndërmarrjes së ndërtim minierave metalore në Tiranë, si vijon:

- | | |
|---|---------------------|
| - Miniera e hekurnikelit Bushtrica e Vjetër | Rrethi i Librazhdit |
| - Sektori minerar mbi horizontin +560 të minierës së hekurnikelit Prrënjës | “ “ |
| - Sektori minerar i kromit Çervenakë | Rrethi i Pogradecit |
| - Miniera e qymyrgurit në Gërdec | “ i Tiranës |
| - Sektori mbi nivelin +240 të minierës së qymyrgurit në Mushqeta | “ i Tiranës |
| - Sektori jugor i minierës së qymyrgurit në Mushqeta | “ “ |
| Sektori “Puse e anekse” Priska-2 i minierës së qymyrgurit në Priskë | Rrethi i Tiranës |
| - Sektorët minerarë të ndërmarrjes së ndërtim minierave metalore në Tiranë, Skroskë dhe Skroska-4 në rrethin e Librazhdit, Guri i Kuq në rrethin e Pogradecit dhe Bitinckë e Rehovë në rrethin e Korçës | |

2. Ministria e Burimeve Minerare dhe Energjetike të hartojë studimet dhe projektet e mbylljes së këtyre minierave dhe sektorëve nëpërmjet Institutit të Teknologjisë Nxjerrëse dhe Përpunuese të Mineraleve në Tiranë dhe të përfundojë procesin e mbylljes gjatë viteve 1996-1997, duke marrë masa për shitjen e makinerive e pajisjeve dhe privatizimin e objekteve sipërfaqësore.

Fondet për kryerjen e studimeve e projekteve dhe për procesin e mbylljes së këtyre minierave e sektorëve, të përballohen nga fondet buxhetore të miratuara për vitin 1996, për konservimin e minierave.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi

VENDIM
Nr.552, datë 26.8.1996

**PËR MIRATIMIN E MEMORANDUMIT TË MIRËKUPITIMIT NDËRMJET REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË DHE REPUBLIKËS ISH-JUGOSLLAVE TË MAQEDONISË, NË
KUADRIN E PROJEKTIT TË ADMINISTRIMIT TË LIQENIT TË OHRIT**

Me propozimin e Ministrisë së Punëve Publike, Rregullimit të Territorit dhe Turizmit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Të miratojë memorandumin e mirëkuptimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës ish-Jugosllave të Maqedonisë, mbi projektin e ruajtjes së liqenit të Ohrit, të mbështetur nga Banka Botërore dhe të financuar nga Global Environmental Facility (GEF).
 2. Të autorizojë Ministrin e Punëve Publike, Rregullimit të Territorit dhe Turizmit, ose personin e ngarkuar prej tij, të nënshkruajë këtë memorandum mirëkuptimi.
 3. Ngarkohet Ministria e Punëve Publike, Rregullimit të Territorit dhe Turizmit dhe Ministria e Shëndetësisë dhe e Mbrojtjes së Ambientit, për ngritjen dhe organizimin e grupeve të mëposhtme:
 1. Bordi i administrimit të liqenit të Ohrit (pjesa shqiptare);
 2. Njësia e Zbatimit të Projektit (PIU);
 3. Grupi i monitorimit;
 4. Grupi i ndërgjegjësimit publik;
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi

VENDIM
Nr.555, datë 26.8.1996

**PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES SË GRANTIT JAPONEZ NDËRMJET SHQIPËRISË
DHE SHOQATËS NDËRKOMBËTARE TË ZHVILLIMIT (IDA) SI ADMINISTRATORE E
FONDEVE GRANT TË DHËNA NGA JAPONIA PËR PËRGATITJEN E PROJEKTIT TË
DYTË TË TRANSPORTIT**

Me propozimin e Ministrisë së Financave dhe të Departamentit të Zhvillimit Ekonomik dhe Koordinimit të Ndihmës së Huaj, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Të miratojë marrëveshjen e grantit japonez ndërmjet Shqipërisë dhe Shoqatës Ndërkombëtare të Zhvillimit (IDA), si administratore e fondeve grant të dhëna nga Japonia, për përgatitjen e projektit të dytë të transportit, për shumën 500 000 USD.
 2. Autorizohet Ministri i Financave, ose ndonjë person tjetër i autorizuar prej tij, të nënshkruajë marrëveshjen grant japonez të lartpërmendur, si dhe dokumentet e tjera të lidhura me të.
 3. Ngarkohet Ministria e Industrisë, Transporteve dhe Tregtisë për përdorimin e fondeve dhe realizimin e projektit në kuadrin e kësaj marrëveshjeje.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi

VENDIM
Nr.556, datë 26.8.1996

PËR MIRATIMIN NË PARIM TË PROJEKTIT PËR ADMINISTRIMIN E LIQENIT TË OHRIT

Me propozimin e Ministrisë së Punëve Publike, Rregullimit të Territorit dhe Turizmit dhe të Departamentit të Zhvillimit Ekonomik dhe Koordinimit të Ndihmës së Huaj, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Të miratojë në parim projektin për administrimin e liqenit të Ohrit, që mbështetet nga Banka Botërore dhe Global Environment Facility (GEF).
 2. Financimi për këtë projekt në shumën deri në 4 milionë USD do të mbulohet me grant nga GEF.
 3. Ngarkohet Departamenti i Zhvillimit Ekonomik dhe Koordinimit të Ndihmës së Huaj, Ministria e Punëve Publike, Rregullimit të Territorit dhe Turizmit, Ministria e Financave dhe Komiteti i Mbrojtjes së Ambientit, për zbatimin e këtij projekti dhe negocimin me donatorë të tjerë për financimin e këtij projekti.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi

VENDIM
Nr.587, datë 9.9.1996

PËR DISA NDRYSHIME NË NDARJEN ADMINISTRATIVO-TOKËSORE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Me propozimin e Sekretarit të Shtetit për Pushtetin Lokal, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.269, datë 25.6.1992 “Për ndarjen administrativo-tokësore të Republikës së Shqipërisë” bëhen këto ndryshime:

1. Komuna Maliq në rrethin e Korçës emërtohet bashkia Maliq.
 2. Komuna Himarë në rrethin e Vlorës emërtohet bashkia Himarë.
 3. Komuna Orikum në rrethin e Vlorës emërtohet bashkia Orikum.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi

VENDIM
Nr.593, datë 9.9.1996

PËR ZBATIMIN E “MARRËVESHJES NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË SHBA-SË PËR ZGJIDHJEN E DISA PRETENDIMEVE”, RATIFIKUAR ME LIGJIN NR.7913, DATË 6.4.1995

Me propozimin e Ministrisë së Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në zbatim të “Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Qeverisë së SHBA-së për zgjidhjen e disa pretendimeve”, ratifikuar me ligjin nr.7913, datë 6.4.1995, t’i kthehen Shoqërisë së Misionit Babtist Konservativ pronat në qytetin e Korçës si vijon:

a) Shkolla amerikane që ndodhet në rrugën “Dh.Cickes” (sot rruga”Niko Dodona), e njohur si shkolla amerikane, shkolla “Kennedy” ose misioni “Evangjelist”;

b) Rezidenca dykatëshe e përdorur më parë për banim nga familjet e personelit pas ndërtesës kryesore të shkollës amerikane;

c) Një pronë prej 27 akrash, e njohur si “Kodra Kennedy” në kodrën e “Shën Athanasit” me pamje nga qyteti i Korçës.

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet këshilli i rrethit të Korçës dhe bashkia e Korçës.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi

VENDIM
Nr.594, datë 9.9.1996

PËR MIRATIMIN NË PARIM TË MARRËVESHJES NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË , QEVERISË SË REPUBLIKËS TË ITALISË DHE INSTITUTIT MESDHETAR TË AGRONOMISË PËR ZBATIMIN E PROJEKTIT TË MBROJTJES FITOSANITARE NË SHQIPËRI

Me propozimin e Ministrisë së Bujqësisë dhe të Ushqimit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin në parim të marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë, Qeverisë së Republikës të Italisë dhe Institutit Mesdhetar të Agronomisë për zbatimin e projektit të mbrojtjes fitosanitare në Shqipëri.

2. Ngarkohet Ministri i Bujqësisë dhe i Ushqimit ose i autorizuari i tij, të nënshkruajë marrëveshjen në emër të Qeverisë së Republikës të Shqipërisë.

3. Për zbatimin e marrëveshjes ngarkohet Ministria e Bujqësisë dhe e Ushqimit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi

VENDIM
Nr.602, datë 9.9.1996

PËR PRIVATIZIMIN E SHOQËRISË TREGTARE, MINIERA E BITUMIT SELENICË

Në zbatim të ligjit nr.8026, datë 9.11.1995 “Për privatizimin e shoqërive tregtare që veprojnë në sektorin mineral”, me propozimin e Ministrisë së Burimeve Minerare dhe Energjetike dhe të Ministrisë së Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Të autorizojë Agjencinë Kombëtare të Privatizimit për privatizimin e kapitalit të shoqërisë anonime Miniera e Bitumit Selenicë në Vlorë, sipas përcaktimeve dhe kushteve të vendosura nga komisioni i ekspertëve (i ngritur për këtë qëllim nga Ministria e Burimeve Minerare dhe Energjetike dhe Ministria e Financave) dhe të paraqitura në lidhjen që i bashkëngjitet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi

KUSHTET E KONTRATËS SË SHITJES

Objekti: Miniera e Bitumit Selenicë sh.a., Vlorë;
Përqindja e aksioneve që privatizohen: 70 për qind;
Vlefë: 51 milionë lekë;
Mënyra e pagesës: në lekë;
Firma fituese VEFA Holding;
Investimet e ardhshme: 940 milionë lekë në vitet 1996-2000;
Kushte të tjera: Mbrojtja e mjedisit, mbrojtja në punë e fuqisë punëtore ekzistuese dhe rritja e numrit të tyre në të ardhmen.

VENDIM
Nr.655, datë 23.9.1996

PËR MIRATIMIN E STRATEGJISË SË PRIVATIZIMIT TË BANKAVE TREGTARE SHTETËRORE

Në zbatim të ligjit nr.8033, datë 16.11.1995 “Për transformimin e bankave tregtare shtetërore në shoqëri tregtare dhe lejin e privatizimit të tyre”, me propozimin e Ministrisë së Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e strategjisë së privatizimit të bankave tregtare, që i bashkëlidhen këtij vendimi.
 2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Ministria e Financave, Ministria e Privatizimeve dhe institucionet e tjera që kanë lidhje me privatizimin e bankave shtetërore tregtare.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

STRATEGJIA E PRIVATIZIMIT TË BANKAVE TREGTARE SHETËRORE

1. BAZA LIGJORE

1.1 Kjo strategji hartohet në përputhje me ligjin nr.8033, datë 16.11.1995 “Për transformimin e bankave tregtare shetërore në shoqëri tregtare dhe lejin e privatizimit të tyre” dhe ligjin nr.8075, datë 22.2.1996 “Për sistemin bankar në Republikën e Shqipërisë”. Ky dokument trajton parimet, etapat, mënyrat dhe teknikat e privatizimit të bankave shetërore.

1.2 Ky dokument parashtrohet objektivat afatshkurtër dhe afatmesëm të qeverisë për privatizimin e bankave shetërore, si dhe rolin e qeverisë, Bankës së Shqipërisë dhe vetë bankave në procesin e privatizimit.

1.3 Ky dokument do të shërbejë për të krijuar bazën mbështetëse për punën dhe vendimet operative të ministrave përkatëse dhe të bankave shetërore gjatë gjithë procesit të privatizimit.

2. QËLLIMI

2.1 Qeveria privatizon bankat shetërore, duke synuar përsosjen e sistemit bankar aktual dhe krijimin e një sistemi bankar efektiv, të qëndrueshëm dhe të shëndoshë financiarisht, që të jetë mbështetje për rritjen e shpejtë të ekonomisë së vendit. Privatizimi i bankave shetërore do të bëhet shkallë-shkallë brenda një periudhe të pranueshme. Për këtë arsye qeveria synon që brenda vitit 2000 të realizohet privatizimi tërësor i secilës bankë shetërore. Kjo përbën edhe qëllimin final të procesit të privatizimit të bankave shetërore në veçanti dhe të reformimit të sistemit bankar në tërësi.

3. OBJEKTIVAT E QEVERISË NË PROCESIN E PRIVATIZIMIT TË BANKAVE SHETËRORE

Objektivat e qeverisë në procesin e privatizimit të bankave shetërore do të jenë:

a) Krijimi i një sistemi bankar të fortë, efektiv dhe konkurrues.

Duke privatizuar bankat, krijohet mundësia për modernizimin dhe përmirësimin e cilësisë së shërbimeve bankare, futjen e produkteve e të teknologjive të reja.

b) Shitja tek investitorët strategjikë, duke synuar shpërndarje të gjërë të pronësisë mbi kapitalin.

Shpërndarja e kapitalit në procesin e privatizimit të jetë sa më e gjërë, por në të njëjtën kohë do të synohet edhe drejtimi i korporatizuar i bankës.

c) Zhvillimi i tregjeve kombëtare të kapitalit.

Privatizimi i bankave shetërore do të ndihmojë procesin e zhvillimit të tregjeve të kapitalit në vendin tonë, si dhe në tërheqjen e investimeve të huaja.

ç) Mbrojtja e interesave të klientëve të bankës dhe të investitorëve të vegjël.

d) Kalimi tërësor i bankave në duart e sektorit privat. Kjo përbën dhe qëllimin afatmesëm të qeverisë në procesin e privatizimit. Por gjatë kësaj periudhe, në përputhje me zhvillimet fiskale, qeveria do të ruajë përkohësisht ose një bankë shetërore ose kontrollin mbi një bankë.

4. PËRPARËSITË E QEVERISË PËR BLERËSIT

4.1 Qeveria konsideron si blerës të mundshëm të bankave shetërore investitorët vendas dhe të huaj, të cilët plotësojnë kriteret e vendosura për përzgjedhjen e tyre. Investitorët vendas, që klasifikohen si të përshtatshëm për të blerë bankat, janë personat fizikë ose juridikë. Investitorët e huaj, që klasifikohen si të përshtatshëm për të blerë bankat, janë institucionet bankare dhe institucionet financiare. Individët e huaj do të klasifikohen në atë masë sa të mos kenë të drejtën e kontrollit në bankë.

4.2 Përparësi në blerje do të kenë investitorët strategjikë institucionalë, që ofrojnë blerjen e më shumë se një të tretës së aksioneve me të drejtë vote në bankën që privatizohet, deri në shumicën absolute të aksioneve të bankës.

4.3 Për qëllime të këtij dokumenti me “investitor strategjik institucional” do të kuptohet çdo institucion bankar dhe institucion financiar jobankar i njohur në tregjet financiare ndërkombëtare, që është klasifikuar si i përshtatshëm për të blerë bankën.

4.4 Si kriterë të klasifikimit të investitorëve si të përshtatshëm për të blerë bankën, në rastin

kur ato ofrojnë blerjen e mbi 10% të aksioneve me të drejtë vote të bankës që privatizohet, do të shërbejnë kërkesat që shtrën rregullorja e Bankës së Shqipërisë për licencimin e bankave.

5. METODAT E SHITJES SË BANKAVE

Bankat shtetërore do të shiten me njëri nga metodat e mëposhtme:

5.1 Shitja me tender

Shitja me tender parashikon ofrimin e çmimeve për blerje nga të paktën tre investitorë të klasifikuar si të përshtatshëm për të blerë bankën, të zgjedhur nga një ofertë të bërë në një gazetë të specializuar ndërkombëtare.

Ministria e Financave dhe Ministria e Privatizimeve do të përgatitin ofertën për shitje të bankës. Në këtë proces ato do të asistohen nga pikëpamja teknike nga një kompani e specializuar në këtë fushë. Ministria e Financave do të bëjë përzgjedhjen e kompanive që do të japin asistencë për përgatitjen e programit të privatizimit dhe realizimin e shitjes së bankave.

5.2 Shitje me negociata

Me miratim të qeverisë, shitja me negociata parashikon zhvillimin e bisedimeve ndërmjet palëve të interesuara.

5.3 Oferta publike

Oferta publike parashikon tregtimin në bursë të aksioneve të bankës që privatizohet.

5.4 Shitja e bankës klientëve të saj

5.5. Shitja me kombinim të formave të mësipërme

6. SHITJA E PAKETËS EKZISTUESE DHE REDUKTIMI I PJESËMARRJES SHTETËRORE NËPËRMJET SHITJES SË PJESËS SË SHITUAR TË TIJ

6.1 Në rastin kur banka vlerësohet relativisht e kapitalizuar dhe me një portofol huash e investimesh të mira, shteti shet paketën ekzistuese të aksioneve, kurse në rastin e domosdoshmërisë së rikapitalizimit të bankave shtetërore dhe të një portofoli jo të mirë huash dhe investimesh, qeveria preferon rritjen e kapitalit të bankave nëpërmjet nënshkrimit publik ose privat të aksioneve të emetuara rishtazi.

6.2 Nënshkrimi privat mund të bëhet nga investitorë privatë që kërkojnë të blejnë më shumë se 10% të shtesës së kapitalit dhe nga depozitues individë brenda vlerës së depozitës së tyre mesatare për vitin e fundit. Nënshkrimi publik i aksioneve të emetuara rishtazi duhet të bëhet sipas ligjeve në fuqi në kohën e nënshkrimit.

7. FLEKSIBILITETI I QEVERISË KUNDREJT KËRKESAVE TË BLERËSIT KUR AI ËSHTË NJË INVESTITOR STRATEGJIK INSTITUCIONAL

7.1 Në rast se blerësit janë investitorë strategjikë institucionalë, të klasifikuar si të përshtatshëm për të blerë bankën, bankat do të ofrohen për shitje si një e tërë. Kur kjo është e pamundur, qeveria do të negociojë me investitorët, në përputhje me aktet ligjore në fuqi. Në këtë rast do të ofrohet për shitje vetëm pjesa e pastër e bankës, duke synuar një çmim më të lartë.

8. FAZAT E PROCESIT TË PRIVATIZIMIT TË BANKAVE SHTETËRORE

Procesi i privatizimit të bankave shtetërore do të kalojë nëpër katër faza:

8.1 Parapërgatitja për privatizim. Në këtë fazë do të punohet në këto drejtime:

a) Përgatitja dhe miratimi i strategjisë së privatizimit, e cila do të publikohet.
b) Shndërrimi i bankave tregtare me kapital shtetëror në shoqëri tregtare, regjistrimi si shoqëri anonime dhe licencimi i tyre në mbështetje të ligjit nr.8075, datë 22.2.1996 “Për sistemin bankar në Republikën e Shqipërisë” dhe rregullores së Bankës së Shqipërisë për licencimin e bankave.

c) Futja e standardeve të reja kontabël të njësuara me ato të pranuara në shkallë botërore (IAS).

ç) Auditingu dhe vlerësimi paraprak i bankave.

d) Caktimi i këshilltarëve të qeverisë e të bankave, për procesin e privatizimit.

8.2 Përgatitja për privatizim Në këtë fazë do të synohet:

a) Ristrukturimi i bankave, kur ai është i mundur.
b) Përcaktimi i pjesës që do të shitet.
c) Kërkimi i investitorëve strategjikë, në bashkëpunim me Bankën e Shqipërisë dhe me institucionet ndërkombëtare.

8.3 Miratimi i formulës dhe i planit të privatizimit. Në këtë fazë zgjidhen detyra të tilla:

a) Miratimi i formulës së privatizimit për secilën bankë.

b) Hartimi i planit të privatizimit dhe i rregulloreve përkatëse.

Miratimi i formulës së privatizimit për çdo bankë do të bëhet nga Kuvendi Popullor.

8.4 Privatizimi i bankave.

9. VLERËSIMI I BANKËS DHE KOSTOJA E QEVERISË

9.1 Vlerësimi i bankës që privatizohet do të bëhet me vlerën e tregut.

9.2 Të ardhurat nga privatizimi i bankave qeveria do t'i përdorë për sistemin bankar. Kostoja e privatizimit të bankave do të përballohet (sa të jetë e mundur) nga burime të huaja dhe në fund nga Buxheti i Shtetit.

10. KONSIDERATA PËR FORMULËN DHE RADHËN PARËSORE TË PRIVATIZIMIT TË BANKAVE

10.1 Në përgatitjen e formulës së privatizimit të çdo banke dhe në paraqitjen e saj në Kuvendin Popullor do të kihet parasysh qëllimi, objektivat e qeverisë për privatizimin e bankave, si dhe analizat që do të kryhen për këtë qëllim për çdo bankë që privatizohet.

10.2 Qeveria angazhohet për të privatizuar së pari Bankën Tregtare Agrare dhe më pas Bankën Kombëtare Tregtare dhe Bankën e Kursimeve.

10.3 Për bankat që do të privatizohen, qeveria synon të arrijë privatizimin e tyre, duke u ofruar, së pari, për shitje bankat investitorëve strategjikë institucionalë. Më vonë një pjesë të aksioneve qeveria synon ta shpërndajë për investitorët vendas dhe klientët e bankave.

11. ROLI I KËSHILLTARËVE TË HUAJ, AUTORITETI DHE PËRGJEGJËSITË E TYRE

11.1 Ministria e Financave dhe Ministria e Privatizimeve, në procesin e privatizimit të bankave shtetërore, do të aktivizojë institucione të specializuara në rolin e këshilltarëve financiarë e juridikë, të cilët kanë përvojë në privatizimin e bankave.

11.2 Detyrat dhe përgjegjësitë e tyre do të caktohen në termat e referencës që do miratohen nga Ministria e Financave dhe Banka e Shqipërisë. Për zgjedhjen e këshilltarëve të huaj do të zbatohen standardet ndërkombëtare dhe ligjet në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

12. ROLI DHE DETYRAT E INSTITUCIONEVE NË PROCESIN E PRIVATIZIMIT

Procesi i privatizimit do të drejtohet nga Ministria e Financave dhe Ministria e Privatizimeve, në bashkëpunim me Bankën e Shqipërisë, bankat shtetërore që do të privatizohen dhe këshilltarët e huaj.

Me hyrjen në fuqi të strategjisë së privatizimit, do të përcaktohen detyrat e secilit institucion.

VENDIM

Nr.668, datë 7.10.1996

PËR MARRJEN NË DORËZIM TË ARIT SHQIPTAR TË GRABITUR NGA GJERMANËT GJATË LUFTËS SË DYTË BOTËRORE

Në zbatim të ligjit nr.7913, datë 6.4.1995 “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe SHBA-së, për zgjidhjen e disa pretendimeve” dhe ligjit nr.8141, datë 5.9.1996 “Për ratifikimin e memorandumit të mirëkuptimit ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar për problemin e arit të grabitur nga gjermanët”, si dhe marrëveshjen ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Franceze lidhur me zgjidhjen e çështjes së arit monetar dhe të detyrimeve të tjera publike dhe private, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Të ngrihet grupi i punës për marrjen në dorëzim të arit shqiptar nga komisioni trepalësh, i përbërë prej:

- Kristaq Luniku Guvernatori i Bankës së Shqipërisë;

- Sherafedin Shehu zv. Ministër i Financave;

- Albert Bejo Drejtor Juridik në Ministrinë e Punëve të Jashtme.

2. Ngarkohet Banka e Shqipërisë të kalojë për llogari të SHBA-së dhe të Qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar shumat në dollarë amerikanë të detyrimeve të përcaktuara në ligjin nr.7913,

datë 6.4.1995 “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe SHBA-së, për zgjidhjen e disa pretendimeve” dhe ligjin nr.8141, datë 5.9.1996 “Për ratifikimin e memorandumit të mirëkuptimit ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar për problemin e arit të grabitur nga gjermanët”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi

VENDIM
Nr.676, datë 14.10.1996

**PËR FILLIMIN E PUNËS SË ZYRËS SË REGJISTRIMIT TË PASURISË SË
PALUAJTSHME NË DISA RRETHE TË VENDIT**

Në mbështetje të neneve 56 dhe 57 të ligjit nr.7843, datë 13.7.1994 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, me propozimin e Kryetarit të Këshillit të Ministrave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në rrethet Berat, Devoll, Dibër, Durrës, Fier, Korçë, Kuçovë, Mat, Tiranë(2) e Vlorë, me qendër në këto qytete, çelet dhe fillon punën Zyra e Regjistrimit të Pasurisë së Paluajtshme.
2. Ministria e Drejtësisë dhe kryeregjistrusi i pasurisë së paluajtshme të marrin masat për transportimin, sistemimin dhe sigurimin e regjistrave të zyrave të hipotekës së këtyre rretheve pranë gjykatës së shkallës së parë, për të mbajtur të paprekura vlerat provuese e historike të tyre.
3. Personeli i hipotekave të këtyre rretheve do të kalojë brenda strukturës administrative të zyrave të regjistrimit me urdhër të përbashkët të Ministrit të Drejtësisë dhe kryeregjistrusit të pasurisë së paluajtshme.
4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Ministria e Drejtësisë dhe kryeregjistrusi të pasurisë së paluajtshme.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi

VENDIM
Nr.677, datë 7.10.1996

**PËR MIRATIMIN NË PARIM TË MARRËVESHJES NDËRMJET QEVERISË SË
REPUBLIKËS FEDERALE TË GJERMANISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS TË
SHQIPËRISË PËR BASHKËPUNIM FINANCIAR**

Në kuadrin e bashkëpunimit teknik e financiar ndërmjet Republikës Federale të Gjermanisë dhe Qeverisë së Republikës të Shqipërisë, me propozimin e Ministrisë së Financave dhe Departamentit të Zhvillimit Ekonomik dhe Koordinimit të Ndihmës së Huaj, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin në parim të marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë dhe Qeverisë së Republikës të Shqipërisë për bashkëpunimin financiar, për shumën 10 000 000 DM, për projektin “Institucioni financiar për ndërmarrje të vogla dhe të mesme”.

2. Autorizohet Ministri i Financave, ose një përfaqësues i autorizuar prej tij, të nënshkruajë marrëveshjen me Qeverinë e Republikës Federale të Gjermanisë.

3. Ngarkohet Banka e Shqipërisë për të negociuar dhe përfunduar marrëveshjet përkatëse me Kreditanstalt für Wiederaufbau, si dhe për përcaktimin e bankës së nivelit të dytë për zbatimin e projektit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi

VENDIM
Nr.693, datë 23.10.1996

PËR MIRATIMIN NË PARIM TË AKTEVE "MBI HEQJEN DORË NGA TË DREJTAT"
DHE "MBI MARRJEN NË DORËZIM" TË ARIT SHQIPTAR TË GRABITUR NGA
GJERMANËT GJATË LUFTËS SË DYTË BOTËRORE

Në zbatim të ligjit nr.7913, datë 6.4.1995 "Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe SHBA-së, për zgjidhjen e disa pretendimeve" dhe të ligjit nr.8141, datë 5.9.1996 "Për ratifikimin e memorandumit të mirëkuptimit ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar për problemin e arit të grabitur nga gjermanët", si dhe të marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Franceze lidhur me zgjidhjen e çështjes së arit monetar dhe të detyrimeve të tjera publike dhe private, miratuar në parim me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.667, datë 19.2.1996, me propozimin e Bankës së Shqipërisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Të miratojë në parim aktet "Mbi heqjen dorë nga të drejtat" dhe "Mbi marrjen në dorëzim" të arit shqiptar të grabitur nga gjermanët gjatë Luftës së Dytë Botërore.

2. Autorizohet zoti Kristaq Luniku, Guvernator i Bankës së Shqipërisë, si përfaqësues i Qeverisë së Republikës të Shqipërisë, të nënshkruajë aktet e sipërpërmendura.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi

VENDIM
Nr.696, datë 14.10.1996

PËR FUNKSIONIMIN E KOMISIONIT TË LETRAVE ME VLERË

Në zbatim të ligjit nr.8080, datë 1.3.1996 "Për letrat me vlerë", me propozimin e Ministrisë së Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Komisionit të Letrave me Vlerë, për vitin 1996, nga fondi kontingjencë i Buxhetit të Shtetit

t'i jepen 2 milionë lekë, nga të cilat 1,5 milionë lekë për shpenzime korente dhe 0.5 milionë lekë për investime.

2. Paga mujore e drejtorit ekzekutiv të jetë 30 000 lekë. Për profesionistët teknikë, zyrtarët dhe personelin tjetër administrativ, pagat të caktohen në nivelin e pagave për funksione të ngjashme në ministri dhe institucione të tjera qendrore.

3. Shpërblimi i komisionerëve dhe kryetarit të komisionit të jetë deri në 5000 lekë për çdo mbledhje.

Shpërblimi i anëtarëve të komiteteve dhe kryetarëve të tyre të jetë në 2000 lekë për çdo mbledhje.

Masa e shpërblimit për secilin funksion caktohet nga kryetari i Komisionit të Letrave me Vlerë.

Këto shpërblime jepen sipas kritereve të caktuara në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.720, datë 29.11.1995 "Për shpërblimin e punonjësve buxhetorë që aktivizohen në veprimtari të tjera dytësore shtetërore".

4. Për kryerjen e funksioneve të veta Komisionit të Letrave me Vlerë i vihen në administratim 4 zyra në ndërtesën e "ish-Komitetit Qendror" kati III, majtas.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi

VENDIM
Nr.762, datë 11.11.1996

**PËR PAGIMIN E KUOTËS TË STATUSIT TË VËZHGUESIT TË SHQIPËRISË NË
ORGANIZATËN BOTËRORE TË TREGËTISË**

Për të respektuar marrëveshjet me disa organizma ndërkombëtarë që paraqesin interes për vendin tonë, me propozimin e Ministrisë së Industrisë, Transportit dhe Tregtisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Të paguhet kuota e statusit të vëzhguesit të Shqipërisë në Organizatën Botërore të Tregtisë për vitet 1995 dhe 1996, në shumën 27 200 USD ose 2 720 000 lekë, që përballohen nga fondet e parashikuara në buxhetin e Ministrisë së Industrisë, Transportit dhe Tregtisë për vitin 1996.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi

VENDIM
Nr.765, datë 18.11.1996

PËR NGRITJEN E KËSHILLIT DREJTUES TË ENTIT KOMBËTAR TË ZONAVE TË LIRA

Në zbatim të ligjit nr.8072, datë 15.2.1996 "Për zonat e lira", Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Caktimin e dy anëtarëve të këshillit drejtues të Entit Kombëtar të Administrimit të Zonave të Lira, si vijon:

z.Nikolin Pano - kryetar

z.Selami Xhepa - anëtar

2. Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.393, datë 3.9.1992 “Për pagat e punonjësve në institucionet buxhetore” në pikën 8 të lidhjes nr.1 dhe në pikën 3 të lidhjes nr. II-5 shtohet emërtimi “Kryetar i këshillit drejtues të Entit Kombëtar të Administrimit të Zonave të Lira”.

3. Shpërblimi i anëtarëve të këshillit drejtues të jetë deri në 5 000 lekë për çdo mbledhje. Masa e shpërblimit caktohet nga kryetari.

4. Për realizimin e veprimtarisë, Entit Kombëtar të Administrimit të Zonave të Lira, për periudhën dhjetor 1996, i miratohet një buxhet prej 100 mijë lekësh nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.

5. Për kryerjen e funksioneve të veta, Entit Kombëtar të Administrimit të Zonave të Lira, i vihen në administrim 2 zyra në ndërtesën e “ish-Komitetit Qendror” kati III, majtas.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi

Bulevardi Zhan d'Ark, pranë ish-ekspozitës "Shqipëria Sot".
Tel: 042 555 63; 267 468

Pranë **Qendrës së Publikimeve Zyrtare** mund të gjeni:

BOTIMET:

1.	KUSHTETUTA (edhe anglisht)	600
2.	KODI I PROCEDURËS CIVILE	500
3.	KODI I PROCEDURËS PENALE	600
4.	KODI PENAL	400
5.	KODI I PUNËS	500
6.	KODI I FAMILJES	450
7.	KODI CIVIL	1000
8.	KODI RRUGOR DHE LIGJ PËR TRANSPORTIN	900
9.	KODI ZGJEDHOR	355
10.	DISPOZITA ZBATUESE TË KODIT RRUGOR	1500

PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI

11.	PËRMBLEDHJE E LEGJISLACIONIT NË FUSHËN E PËRMBARIMIT	800
12.	PËRMBLEDHJE E LEGJISLACIONIT NË FUSHËN E PROKURIMIT PUBLIK	1000
13.	KODI I PROCEDURAVE ADMINISTRATIVE	500
14.	PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR NËPUNËSIN CIVIL	600
15.	PËRMBLEDHJE NË FUSHËN E TAKSAVE DHE TATIMEVE	1500

DOLI NGA SHTYPI

TREGUESI KRONOLOGJIK I LEGJISLACIONIT SHQIPTAR 1990-KORRIK 2004	1500
TREGUESI TEMATIK I LEGJISLACIONIT SHQIPTAR 1990-KORRIK 2004	2000

Doli nga shtypi më 8.10.2005

Tirazhi: 4300 copë	Formati: 60x88/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2005

Çmimi 150 lekë